



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 9.10.2017, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES KONSTITUIVE TË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë : Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Srdjan Mitrovic, Liburn Aliu, Salih Salihu, Ali Lajçi, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Enver Hoti, Danush Ademi.

Mungoi : Ganimete Musliu .

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Daut Haradinaj-kryetar** dhe fillimisht njoftoi komisionin se kjo mbledhje është konstituive dhe në shërbim të njoftimit me anëtarë të komisionit, ai ju dëshiroi punë të mbarë anëtarëve të komisionit në legjislacionin e VI duke shprehur besimin se ky komision do të vazhdoi punën me sukses aty ku ka mbetur komisioni nga legjislatura e V, ngase siç shihet nga raporti fund mandator, mjaft projektligje nuk kanë arrit të përfundojnë të cilat sërish do të dërgohen gjatë këtij legjislacioni. Ai shprehu besimin në punën e suksesshme të këtij komisioni dhe pyeti komisionin a pajtohen për mbledhjen e parë të ftohen dy ministrat me sekretarët permanent në funksion të njoftimit të komisionit me aktivitetet e parapara në dy fushat që i përkasin komisionit. **Besa Gaxherri** dhe **Andin Hoti** përshëndetën komisionin dhe uruan sukses kurse **Salih Salihu** ish anëtarë i këtij komisioni potencoi disa çështje të rëndësishme të cilat komisioni nuk ka arrit të përfundoi në mandatin e kaluar, sidomos kërkoi angazhim rreth hartimit të ligjit për standardizimin e prodhimit të bukës në Kosovë nëse qeveria nuk dërgon një projektligj të tillë. **Enver Hoti, Ali Lajçi** dhe **Danush Ademi** u bashkëngjitën urimit për punë të suksesshme të komisionit kurse **Liburn Aliu** ish anëtarë i këtij komisioni, potencoi disa ligje me rëndësi siç janë për legalizime, odën e arkitektëve, banimi social, toka ndërtimore etj dhe monitorimet të cilat duhet të praktikohen si pjesë e domosdoshme e punës së komisionit.

Duke përmbyll mbledhjen, **kryetari** falënderoi dhe mbështeti iniciativat e parashtruara nga disa anëtarë duke cekur edhe disa tjera sa i përket pyjeve dhe uzurpimeve, grandeve dhe ndarjes së tyre në mënyrë të barabartë, akcizave (favorizimi i venës vendore) dhe çështjeve doganore, operatorëve ilegal të guroreve që abuzojnë vendet me rëndësi historike si p.sh urën e shenjt etj. Mbledhja e radhës u caktua për dt. 23 tetor ku do të ftohen dy ministrat e ministrive të bujqësisë dhe mjedisit.

Mbledhja përfundoi në orën 11,40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Daut Haradinaj